

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Operacion blic i SPAK, arrestohet një person me rrezikshmëri të lartë! Shpallet në kërkim një tjetër (EMR AT) - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/operacion-blic-i-spak-arrestohet-nje-person-me-rrezikshmeri-te-larte-shpallet-ne-kerkim-nje-tjeter/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 08:40:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 08:37:15 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fcac0e41bc5a2ec3f56c3a680aac906e76953873451858e1531e183c9932bd3e
TEKSTI	67a4244bc780157dcddb17c9d895ca81aa7fa2142224e1cc53652cfe0af814a8
PAMJA	08134e716c0156f7206e89d257b7cf70cfef40baf0b0c61f051feebf2b8d5e9d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	105ffdbda6782a548843702d7eabf97c7c194546e273ba5a0cf6f37b05ae5723
E MËPARSHMJA	73b1f8945a14af53cc0315065a939b1a99ec8beb1c044506a6e926eae77bb9c1
RRËNJA MERKLE	aeabf4509e171eed592273ece5cddf4aeb2f22a188459bccfd99accd67acf91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/105ffdbda6782a548843702d7eabf97c7c194546e273ba5a0cf6f37b05ae5723>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Donald Trump Gjyqi i UÇK Indrit Dokle Vlora Hyseni

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

Operacion blic i SPAK, arrestohet një person me rrezikshmëri të lartë! Shpallet në kërkim një tjetër (EMRAT)

26 Shtator 2026 | 10:37

SPAK ka zhvilluar këtë të shtunë një operacion blic në qytetin e Shkodrës ku mësohet se është vënë në pranga një 50-vjeçar me rrezikshmëri të lartë shoqërore. I arrestuari është identifikuar si Bledar Cafti.

Kapja dhe arrestimi i tij u bë në orët e para të mëngjesit të sotëm, në banesën e tij në Shkodër. Mësohet se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka caktuar ndaj tij masën "Arrest me burg" për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike", kryer në bashkëpunim, në formë të grupit të strukturuar kriminal, si dhe "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Në njoftimin e policisë, bëhet me dije se po vijon puna për kapjen e një personi tjetër, i cili gjatë operacionit nuk u gjet në banesë. Mësohet se në kërkim është shpallur Endrit alias Indrit Dokle.

Njoftimi i plotë:

Finalizohet operacioni policor i koduar "Muri i Lartë". Operacioni nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me BKH-në, nën drejtimin e SPAK.

Kapet dhe vihet në pranga një shtetas me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Vijon puna për kapjen e një shtetasi tjetër, i cili gjatë operacionit nuk u gjet në banesë.

Strukturat operacionale dhe hetimore të Policisë së Shtetit, konkretisht Forcat Speciale Renea, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Drejtoria për Hetimin e Narkotikëve, DVP Shkodër dhe BKH, nën drejtimin e SPAK, në zbatim të urdhrit të Prokurorisë së Posaçme SPAK dhe të vendimit të Gjykatës, kanë zhvilluar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Muri i Lartë", me qëllim ekzekutimin e masës së sigurimit personal ndaj një shtetasi, si dhe kryerjen e kontrolleve për lokalizimin dhe kapjen e një shtetasi tjetër, i shpallur në kërkim.

Në kuadër të operacionit, në Shkodër u bë e mundur kapja dhe arrestimi i shtetasit B. C., 50 vjeç, lindur dhe banues në Shkodër, person me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Kapja dhe arrestimi i tij u bë në orët e para të mëngjesit të sotëm, në banesën e tij në Shkodër. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë 25.09.2026, ka caktuar për këtë shtetas masën e sigurimit personal "Arrest me burg" për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike". kryer në bashkëpunim. në formë të

LAJMI I FUNDIT

10:53 Dalin pamjet nga operacioni i SPAK në Shkodër, momenti i arrestimit të 50-vjeçarit me rrezikshmëri të lartë (VIDEO)

10:38 Polonia i ofron stimuj financiarë SHBA-së, teksa përparojnë bisedimet për bazën ushtarake

10:30 Lula ndalon lojërat e fatit online përpara zgjedhjeve presidenciale në Brazil

SHFËRNDAJE ARTIKULLIN

10:30 Dosja e 'SHISH', Bashkimi European: Kemi besim të plotë te SPAK

10:25 Kaos me pasoja serioze, agjentët e OpenAI dalin jashtë kontrollit! Implikohen faqet e qeverisë amerikane

10:25 Kishte vjedhur një automjet, gjatë arratisjes goditi 4 makina! Vihet në pranga 30-vjeçari në Durrës (VIDEO)

TESTIM

grupit të strukturuar kriminal, si dhe “Grup i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.

Po në zbatim të vendimit të GJKKO-së, u ushtrua kontrolli në vendet që i përkasin shtetasit në kërkim E. D., alias I. D., 43 vjeç, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, person në kërkim që prej vitit 2024, për të cilin GJKKO ka caktuar masën e sigurisë “Arrest me burg” për veprat penale “Trafikim i lëndëve narkotike”, kryer në bashkëpunim, në formë të grupit të strukturuar kriminal, si dhe “Grup i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.

Gjatë kontrolleve, ky shtetas nuk u gjet dhe vijon puna për lokalizimin dhe kapjen e tij.

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI | VIDEO

Kishte vjedhur një automjet, gjatë arratisjes goditi 4 makina! Vihet në pranga 30-vjeçari në Durrës (VIDEO)

Një 30-vjeçar është vënë në pranga nga policia në Durrës. Arrestimi i tij mësohet se ka ardhur pasi ai ka vjedhur një automjet. Sipas njoftimit, autori...

10:25 | 26/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Arrestohet në Rinas 53-vjeçari ukrainas, ishte shpallur në kërkim për trafik droge

Një 53-vjeçar ukrainas është arrestuar në aeroportin e Rinasit, pasi rezultonte i shpallur në kërkim nga autoritetet e Kievit për trafik të lëndëve narkotike, në...

09:40 | 26/09/2026

AKTUALITET | SPORT | VENDI

Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, policia plan masash: Ja rrugët që do të kufizohet qarkullimi

Policia e Shtetit ka dalë këtë të shtune me një plan masash për garantimin e rendit dhe sigurisë në kuadër të ndeshjes Shqipëri-Bjellorusi e cila...

09:08 | 26/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara Punësimi

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakti

Follow Euronews on all platforms: